



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të
Shqyrtuara në Procese të Tjera me Shtojcën 1 (Publike)**

**Ushtguesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(2)(d) dhe (3), 12, 21 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 95(5), 104(1)(b), 138, 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 janar 2023, në konferencën përgatitore për gjykimin, Trupi Gjykues urdhëroi: (i) Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe katër ekipet e Mbrojtjes (bashkërisht, "Mbrojtja") që, deri më 1 mars 2023, në orën 16:00, të dorëzonin mocione për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, dhe (ii) palët dhe pjesëmarrësit e tjerë të dorëzonin përgjigjet dhe kundërpërgjigjet e tyre përkatësisht deri më 3 prill 2023, në orën 16:00, dhe 10 prill 2023, në orën 16:00.¹

2. Më 20 shkurt 2023, Mbrojtja e z. Hashim Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") dorëzoi një njoftim për argument mbrojtës ("Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës"),² me të cilin njoftoi Trupin Gjykues, ZPS-në dhe Mbrojtësin e Viktimave për synimin e vet për të paraqitur argumentin mbrojtës të vetëmbrojtjes.

3. Më 1 mars 2023, Mbrojtja dorëzoi një mocion të përbashkët për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes").³

4. Më 2 mars 2023, ZPS-ja iu përgjigj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës ("Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës").⁴

¹ Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1903, rreshtat 5-13.

² F01306, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Thaçit për Argument Mbrojtës*, 20 shkurt 2023.

³ F01331, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 1 mars 2023, me Shtojcën A.

⁴ F01338, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës (F01306)*, 2 mars 2023.

5. Më 6 mars 2023, Mbrojtja e Thaçit kërkoi leje për t'iu kundërpërgjigjur Përgjigjes ndaj Njoftimit ("Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Kundërpërgjigje").⁵
6. Më 9 mars 2023, Trupi Gjykses konstatoi se Përgjigjja e ZPS-së ndaj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës nuk kishte bazë ligjore të vlefshme dhe nuk i ishte parashtruar siç duhet Trupit Gjykses dhe, si rrjedhojë, refuzoi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Kundërpërgjigje.⁶
7. Më 20 mars 2023, Trupi Gjykses mbajti një konferencë për ecurinë e çështjes, gjatë së cilës palët diskutuan gjerësisht aspektin e vetëmbrojtjes.⁷
8. Më 31 mars 2023, ZPS-ja iu përgjigj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes ("Përgjigjja e ZPS-së").⁸
9. Më 11 prill 2023, Mbrojtja iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së ("Kundërpërgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes").⁹

II. PARASHTRIMET

10. Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykses që të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të paraqitura në Shtojcën A të Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes ("faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera").¹⁰ Mbrojtja parashtron se faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera përmbushin kriteret e përcaktuara në rregullën 157, duke qenë se ato: (i) janë

⁵ F01344, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për t'iu Kundërpërgjigjur Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës*, 6 mars 2023.

⁶ F01357, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për t'iu Kundërpërgjigjur Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Njoftimit të Thaçit për Argument Mbrojtës*, 9 mars 2023, para. 9, 11-12.

⁷ Transkripti i seancës, 20 mars 2023, f. 2084-2101, 2103-2111, publik.

⁸ F01411, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 31 mars 2023, me Shtojcën 1.

⁹ F01442, Mbrojtësit e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 11 prill 2023, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzuar më të njëjtën ditë, F01442/RED).

¹⁰ Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, para. 1, 12, që i referohet Shtojcës A të Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes.

shqyrtuar në procese gjyqësore të përfunduara në gjykata të tjera të Kosovës ose në TPNJ; (ii) kanë lidhje me aspekte që kontestohen në procesin aktual; dhe (iii) nuk lidhen me veprimet dhe sjelljen e asnjërit prej të akuzuarve sikurse paraqiten në Aktakuzë.¹¹

11. ZPS-ja përgjigjet se Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes duhet hedhur poshtë pjesërisht, duke qenë se së paku 80 nga 134 fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera nuk përmbushin kriteret për konstatim gjyqësor sipas rregullës 157(2), për arsyet e paraqitura në hollësi në Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.¹²

12. Mbrojtja i kërkon Trupit Gjyqësor të hedhë poshtë kundërshtimet e ZPS-së dhe të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera.¹³

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. KRITERET PËR KONSTATIM GJYQËSOR TË FAKTEVE TË SHQYRTUARA NË PROCES TË TJERA

13. Rregulla 157(2) përcakton se “me kërkesë të një pale, ose proprio motu, pasi të ketë dëgjuar palët dhe kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë trupi gjyqësor mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procese të përfunduara para gjykatave të tjera në Kosovë, apo sisteme gjyqësore të tjera që kanë lidhje me pika që kontestohen në procesin aktual, nëse ato nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit që përmenden si akuza në aktakuzë.”

14. Gjithashtu, jurisprudenca përkatëse sugjeron se për ushtrimin e diskrecionit nga Trupi Gjyqësor në marrjen e vendimit nëse duhet bërë konstatim gjyqësor i

¹¹ Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, para. 6.

¹² Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 19, që i referohet Shtojcës 1 të Kërkesës.

¹³ Përgjigja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 17.

fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, janë relevantë, ndër të tjerë, këta faktorë: (i) faktet e propozuara janë të dallueshme, konkrete, dhe të identifikueshme; (ii) faktet e propozuara, siç janë formuluar nga pala parashtruese, nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga formulimi i aktgjykimit origjinal; (iii) faktet e propozuara nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin e paraqitur në mocionin e palës parashtruese; (iv) faktet e propozuara nuk përmbajnë konstatime apo cilësime ligjore; (v) faktet e propozuara nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal; dhe (vi) faktet e propozuara nuk janë në proces apeli apo rishikimi.¹⁴ Gjatë ushtrimit të diskrecionit nëse duhet bërë konstatim gjyqësor i një fakti të propozuar, Trupi Gjykses në përgjithësi ka hedhur poshtë faktet që përbëjnë thelbin e argumenteve të Prokurorisë.¹⁵ Po kështu, janë hedhur poshtë edhe faktet që janë të përgjithshme, të mjegullta, tendencioze, ose që përbëjnë përfundime të pambështetura me

¹⁴ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Hadžihasanović and Kubura*, IT-01-47-T, Trial Chamber II, Decision on Judicial Notice of Adjudicated Facts Following the Motions Submitted by Counsel for the Accused Hadžihasanović and Kubura on 20 January 2005 ("[Hadžihasanović and Kubura Decision](#)"), 14 April 2005, p. 5; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, Decision on Accused's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Related to Count One ("[Karadžić 21 January 2014 Decision](#)"), 21 January 2014, para. 6; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts with Annex ("[Popović et al. Decision](#)"), 26 September 2006, paras 7-11, 14; *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documentary Evidence](#), 19 December 2003, para. 16; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-PT, Trial Chamber II, Decision on Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94(b) ("[Prlić et al. Decision](#)"), 14 March 2006, para. 12; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts and for Admission of Written Statements of Witnesses Pursuant to Rule 92 bis](#), 28 February 2003, para. 14; *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92, Appeals Chamber, Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber's Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts ("[Mladić Decision](#)"), 12 November 2013, paras 92, 94. Trupi Gjykses vë në dukje se kriteri që faktet e propozuara të mos kenë lidhje me "veprimet dhe sjelljen" e të akuzuarit sikurse paraqiten në Aktakuzë nuk është faktor diskrecional, por parakusht për mundësinë që të bëhet konstatim gjyqësor sipas rregullës 157(2) të Rregullores.

¹⁵ *Shih* ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber II, Decision Granting in Part Prosecution's Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94(B) ("[Stanišić and Župljanin Decision](#)"), 1 April 2010, para. 46; *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-A, Appeals Chamber, Judgement ("[Tolimir Appeal Judgment](#)"), 8 April 2015, paras 33-35. *Shih gjithashtu* *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, Decision on Accused's Motions for Reconsideration of Decisions on Judicial Notice of Adjudicated Facts ("[Karadžić 14 June 2010 Decision](#)"), 14 June 2010, para. 20.

prova.¹⁶ Trupi Gjykues mbajti parasysh gjithashtu edhe mundësinë që pala kundërshtare mund të kërkojë të paraqesë argumente për hedhjen poshtë të një fakti të propozuar, gjë që kushton kohë dhe burime dhe bëhet pengesë për arritjen e efikasitetit gjyqësor që synohet me rregullën 157(2).¹⁷

15. Trupi Gjykues vë në dukje se rregulla 157(2) e Rregullores synon arritjen e efikasitetit gjyqësor duke i dhënë Trupit Gjykues kompetenca diskrecionale për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procese të përfunduara në gjykata të tjera në Kosovë apo sisteme gjyqësore të tjera lidhur me aspektet që po gjykohen në procesin aktual, duke e eliminuar ose zvogëluar kohën e nevojshme për paraqitjen e provave për faktet që janë vërtetuar më parë në procese të tjera.¹⁸ Ndërkohë që bën këtë, Trupi Gjykues duhet të garantojë njëkohësisht edhe respektimin e të drejtave të të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, sikurse kërkohet sipas rregullës 157(2) të Rregullores.¹⁹

16. Duke bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykues konfirmon një prezumim të bazuar mirë për saktësinë e këtyre fakteve, të cilat rrjedhimisht nuk është e nevojshme të vërtetohen sërish gjatë procesit gjyqësor.²⁰ Meqë ky prezumim është i kundërshtueshëm, çdo palë tjetër mund të paraqesë në gjykim prova që kundërshtojnë saktësinë e fakteve në fjalë. Trupi Gjykues ka diskrecion që të pranojë prova që plotësojnë ose konfirmojnë faktin

¹⁶ Shih gjithashtu *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-T, Trial Chamber, Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documents ("[Hadžić Decision](#)"), 23 May 2013, para. 13.

¹⁷ *Shih p.sh.* ICTY, *Popović et al. Decision*, para. 16; *Stanišić and Župljanin Decision*, para. 45.

¹⁸ KSC-BC-2020-05, F00191, Trupi Gjykues I, Vendim mbi Konstatimin Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera ("Vendimi në Çështjen *Mustafa*"), 7 shtator 2021, para. 9. *Shih gjithashtu Karadžić 21 January 2014 Decision*, para. 4; ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-A, Appeals Chamber, *Decision on Anatole Nsengiyumva's Motion for Judicial Notice*, 29 October 2010, para. 10.

¹⁹ Vendimi në Çështjen *Mustafa*, para. 9. *Shih gjithashtu Mladić Decision*, para. 24.

²⁰ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber I, *Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Facts Relevant to the Srebrenica Crime Base*, 22 September 2008, para. 21; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, *Judgement*, 30 January 2015, para. 620; *Stanišić and Župljanin Decision*, para. 25.

për të cilin është bërë konstatim gjyqësor.²¹

B. PRETENDIMI I VETËMBROJTJES

17. Trupi Gjykes vëren se një numër faktesh të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera mbështeten në pretendimin bazë se ato përbëjnë prova relevante për vërtetimin e argumentit të vetëmbrojtjes në lidhje me (disa) akuza.²² Sa u përket fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykes vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit ka parashtruar se gjatë gjithë periudhës që ka lidhje me Aktakuzën, z. Thaçi ndërmori veprime: (i) në përgjigje ndaj përdorimit të menjëhershëm dhe të paligjshëm të forcës nga forca të lidhura me Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Republikën e Serbisë (“forcat serbe”); dhe (ii) në mbrojtje të njerëzve dhe pronave, përfshirë të popullatës civile të Kosovës.²³ Parashtrohet se veprimet e z. Thaçi ishin proporcionale me shkallën e rrezikut që paraqisnin forcat serbe.²⁴ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, e drejta zakonore ndërkombëtare ofron bazë ligjore për përdorimin e argumentit të vetëmbrojtjes, sikurse pasqyrohet në nenet 31(1)(c) dhe (d) të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) dhe është konfirmuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) në Aktgjykimin *Kordić dhe Čerkez*.²⁵ Mbrojtja e Thaçit thotë se efekti ligjor i argumentit të vetëmbrojtjes është përjashtimi i përgjegjësisë penale të z. Thaçi lidhur me krimet dhe format e përgjegjësisë që pretendohen në Aktakuzë.²⁶ Mbi këtë bazë, Mbrojtja e Thaçit kërkon verdikt pafajësie për të gjitha pikat e Aktakuzës.²⁷ Në kontekstin aktual,

²¹ *Shih p.sh. Tolimir Appeal Judgment*, para. 25-26.

²² Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, para. 9, që u referohet fakteve të propozuara 37-105 të shqyrtuara në procese të tjera .

²³ Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës, para. 2.

²⁴ Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës, para. 2.

²⁵ Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës, para. 3, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-T, Trial Chamber, Judgement (“[Kordić and Čerkez Trial Judgment](#)”), 26 February 2001, paras 450-451.

²⁶ Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës, para. 4.

²⁷ Njoftimi i Thaçit për Argument Mbrojtës, para. 4.

Mbrojtja e Thaçit argumenton se pretendimi i vetëmbrojtjes për ligj pranimin e disa fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera që janë relevante për vërtetimin e këtij argumenti mbrojtës.

18. Sipas rregullës 95(5), brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja e njofton Prokurorin e Specializuar për synimin e vet për të përdorur alibinë ose *çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale*, ndër të cilat, aftësia mendore e kufizuar ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.²⁸ As Ligji dhe as Rregullorja nuk përmbajnë dispozita konkrete për argumentin e vetëmbrojtjes. Ndërkohë, Kodi Penal i Kosovës përcakton konceptin e “mbrojtjes së nevojshme”, që në thelb përbën pretendim për vetëmbrojtje.²⁹ Në çështjen gjyqësore *Kordić dhe Čerkez*, Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së vuri në dukje se vetëmbrojtja është argument mbrojtës sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare³⁰ dhe e përshkroi atë si parim të përgjithshëm të së drejtës penale.³¹ Trupi Gjyqësor në dukje se gjatë gjykimit *Krupp*, Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar krahasoi argumentin e “mbrojtjes së nevojshme” me atë të vetëmbrojtjes në një mënyrë që e bëri të qartë se ai do ta kishte konsideruar vetëmbrojtjen si të zbatueshme edhe në rastin e akuzave për krime lufte.³² Trupi Gjyqësor vëren gjithashtu se, në fakt, vetëmbrojtja është shqyrtuar në një numër gjykimesh për krime lufte³³ dhe figuron si një prej arsyeve për përjashtimin e përgjegjësisë penale në GJPN.³⁴

19. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjyqësor gjykon se argumenti i vetëmbrojtjes është pjesë e së drejtës zakonore. Trupi Gjyqësor në dukje gjithashtu se një i akuzuar që paraqitet para gjykatave të tjera në Kosovë ka të drejtën të përdorë argumentin

²⁸ Theksimi i shtuar.

²⁹ Neni 12 i Kodit Penal të Kosovës 2019.

³⁰ [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), paras 448-452.

³¹ [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 449.

³² LRTWC, Vol. X, p. 148. Shih gjithashtu, LRWTC, Vol. 15, 177, ku shprehet i njëjti qëndrim.

³³ *Shih p.sh.* LRTWC, Vol. III, pp. 77, 78 and 79-80; Vol. V, pp. 73 and 76; Vol. XIII, pp. 149-50; Vol. XIV, p. 129. *Shih gjithashtu* [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), paras 448-452.

³⁴ Statuti i GJPN-së, neni 31(1)(c).

e vetëmbrojtjes dhe çdo i akuzuar para DHS-së ka të drejtën e barazisë para ligjit. Për këto arsye, Trupi Gjykes konstaton se argumenti i vetëmbrojtjes mund të përdoret në mënyrë të vlefshme para këtij juridiksioni.³⁵

20. Si çështje paraprake, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë aspektin se cila palë ka detyrimin të vërtetojë (dhe/ose të paraqesë prova që kundërshtojnë) ekzistencën e këtij argumenti mbrojtës. Nga precedentët e cituar më lart është e qartë se, në të gjitha rastet ishte Mbrojtja ajo që mori përsipër detyrimin për të vërtetuar ekzistencën e rrethanave që përligjin përdorimin e këtij argumenti mbrojtës. Ky mendim u shpreh edhe nga Dhoma e Apelit e TPNJ-së në çështjen *Kordić dhe Čerkez*, ku tha se “ekzistenca ose kuadri i vetëmbrojtjes [...] është aspekt që duhet të vërtetohet nga i akuzuari.”³⁶ Me fjalë të tjera, është Mbrojtja ajo që ka detyrimin të vërtetojë elementet e vetëmbrojtjes. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se zhvendoset detyrimi i provës, domethënë që gjatë gjithë kohës i takon prokurorit të vërtetojë elementet e veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat, format e përgjegjësive penale dhe, përfundimisht, përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarit.³⁷

21. Për të përcaktuar nëse provat e paraqitura nga Mbrojtja janë relevante për vërtetimin e argumentit të pretenduar të vetëmbrojtjes, duhet të kuptohen elementet e vetëmbrojtjes. Së pari, si aspekt paraprak, ligjshmëria e përdorimit të

³⁵ Nenet 3(2)(d) dhe (3) dhe 12 të Ligjit.

³⁶ ICTY, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez*, IT-95-14/2-A, Appeals Chamber, Judgement (“[Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#)”), 17 December 2004, paras 835-838.

³⁷ Neni 21(3) i Ligjit; Rregulla 140 e Rregullores. *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Orić*, IT-03-68-T, Trial Chamber II, [Order Concerning Guidelines on Evidence and the Conduct of Parties During Trial Proceedings](#), 21 October 2004, p. 4; *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber I, [Decision on Motion for Prosecution Access to Defence Documents Used in Cross-Examination of Prosecution Witnesses](#), 9 May 2005, para. 9; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, Judgement (“[Čelebići Trial Judgment](#)”), 16 November 1998, paras 599, 601; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-T, Trial Chamber II, [Decision on the Defence Preliminary Motion on the Form of the Indictment](#), 24 February 1999, para. 60; ICTR, *Musema v. Prosecutor*, ICTR-96-13-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 16 November 2001, para. 200; *Zigiranyirazo v. Prosecutor*, ICTR-01-73-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 16 November 2009, para. 75; *Prosecutor v. Ntagerura et al.*, ICTR-99-46-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 7 July 2006, para. 170; *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Appeals Chamber, [Judgment \(Reasons\)](#), 1 June 2001, para. 107; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, SCSL-03-1-T, Trial Chamber II, [Judgment](#), 26 April 2012, para. 180; ICC Statute, Article 66.

forcës nga një shtet kundër një shteti tjetër në vetëmbrojtje³⁸ duhet të dallohet nga argumenti i vetëmbrojtjes në një çështje gjyqësore penale.³⁹ E para zbatohet dhe rregullon me ligj veprimet e një shteti sipas parimit *jus ad bellum*, ndërsa e dyta ka të bëjë me aspektin e ligjshmërisë së sjelljes së një individi sipas të drejtës penale. Rrjedhimisht,

aspekti i legjitimitetit të vendimit për përdorimin e forcës nuk është relevant për përcaktimin e përgjegjësisë penale individuale për shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare; [...] “nga pikëpamja ligjore nuk është relevante nëse sulmi u urdhërua si veprim parandalues, mbrojtës apo sulmues [...]. Aspekti nën shqyrtim është nëse mënyra e kryerjes së veprimit ushtarak [gjatë konfliktit të armatosur] ishte kriminale ose jo”.⁴⁰

Me fjalë të tjera, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në konflikt të armatosur veprimi në vetëmbrojtje ose jo, kjo, në vetvete, nuk përjashton që krimet e kryera në kuadër të saj të cilësohen si shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.⁴¹

22. Kriteret që duhen përmbushur që vetëmbrojtja të funksionojë si argument mbrojtës ndaj akuzave që kanë të bëjnë me pretendime për krime ndërkombëtare janë shumë të rrepta. Kjo pasqyron rëndësinë që bashkësia ndërkombëtare i kushton këtyre ndalimeve ligjore themelore.⁴² Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së në çështjen gjyqësore *Kordić dhe Čerkez* u shpreh se vetëmbrojtja mund të përdoret si

³⁸ *Shih p.sh.* ICJ, *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons, Advisory Opinion* (“[Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons](#)”), *I.C.J. Reports 1996*, p. 226, para. 42. *Shih gjithashtu* ICRC, *Commentary on Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Protection of Victims of International Armed Conflicts (Protocol I)* (“Shpjeguesi i KNKK-së”), 8 June 1977, 1125 UNTS 3, para. 1927.

³⁹ *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Boškoski and Tarčulovski*, IT-04-82-A, Appeals Chamber, Judgement (“[Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment](#)”), 19 May 2010, para. 31, poshtëshënimi 116 (ku theksohet se, megjë në atë çështje gjyqësore nuk u pretendua se operacioni në fjalë ishte kundërveprim ndaj veprimit të një shteti tjetër, neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara nuk ishte relevant për atë çështje).

⁴⁰ ICTY, *Prosecutor v. Đorđević*, IT-05-87/1-T, Trial Chamber II, [Public Judgement with Confidential Annex \(Volume II of II\)](#), 23 February 2011, para. 2053. *Shih gjithashtu* [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment](#), paras 31-32, footnote 116; *Prosecutor v. Martić*, IT-95-11-A, Appeals Chamber, Judgement (“[Martić Appeal Judgment](#)”), 8 October 2008, para. 268; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 812; [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 452.

⁴¹ ICTY, [Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment](#), para. 31.

⁴² [Kordić and Čerkez Trial Judgment](#), para. 452. *Shih gjithashtu* [Martić Appeal Judgment](#), para. 268.

mbrojtje në lidhje me disa veprime, ku sjellja në fjalë përbën “reagim të arsyeshëm, të domosdoshëm dhe proporcional ndaj sulmit”.⁴³ Ajo vuri në dukje gjithashtu se neni 31(1)(c) i Statutit të GJPN-së zbaton dy kriteret në vijim: (i) veprimi duhet të jetë në përgjigje të “përdorimit të menjëhershëm dhe të paligjshëm të forcës” kundër sulmit ndaj një personi ose prone “të mbrojtur”; dhe (ii) veprimi mbrojtës duhet të jetë “proporcional me shkallën e rrezikut”.⁴⁴ Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kordić* gjithashtu theksoi se “çdo argument që ngre pretendimin e vetëmbrojtjes duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të veta dhe të rrethanave konkrete që lidhen me secilën prej akuzave” dhe se fakti që kryesi i pretenduar është përfshirë në “operacione mbrojtëse” nuk është në vetvete arsye për përjashtim të përgjegjësisë penale.⁴⁵ Dhoma theksoi se “operacionet ushtarake për vetëmbrojtje nuk përbëjnë justifikim për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.”⁴⁶

23. Rrjedhimisht, duket se elementet e argumentit mbrojtës të vetëmbrojtjes janë si vijon. Së pari, për të qenë i ligjshëm, veprimi i kryer në vetëmbrojtje duhet të ndërmerret në përgjigje ndaj përdorimit të menjëhershëm dhe të paligjshëm të forcës kundër një personi ose objekti të mbrojtur me ligj prej këtyre sulmeve.⁴⁷ Së dyti, veprimi duhet të jetë i arsyeshëm, duke marrë parasysh rrezikun që kanoset, dhe jo të jetë pasojë e një situatë të krijuar nga kryesi në shkelje të rëndë të ligjit.⁴⁸ Kushti i tretë (“proporcionaliteti”) kërkon që një person mund të përdorë forcë kundër një personi ose objekti të mbrojtur vetëm nëse nuk ka asnjë alternativë të arsyeshme dhe shkalla e forcës së përdorur duhet të jetë minimumi i

⁴³ *Kordić and Čerkez Trial Judgment*, para. 449.

⁴⁴ *Kordić and Čerkez Trial Judgment*, para. 451. *Shih gjithashtu* ICC Statute, Article 31(1)(c).

⁴⁵ *Kordić and Čerkez Trial Judgment*, para. 452. *Shih gjithashtu* më sipër, para. 21.

⁴⁶ *Kordić and Čerkez Trial Judgment*, para. 452.

⁴⁷ *Shih* nenin 31(1)(c) të Statutit të GJPN-së.

⁴⁸ Për shembull, kundërraprezaljet nuk mund të arsyetohen mbi bazën e vetëmbrojtjes në rastet kur pala që kërkon miratim të atyre masave ka kryer një shkelje të rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare që rezultoi në raprezalje nga pala kundërshtarë. *Shih* Law Reports of Trials of War Criminals (“LRTWC”), Vol. XIV, pp. 136-137, Vol. XV, p. 181.

domosdoshëm që individi në fjalë ka në dispozicion në mënyrë të arsyeshme.⁴⁹ Forca mund të përdoret vetëm për të mbrojtur vetveten (ose një person a objekt tjetër të mbrojtur me ligj) nga dëmi, dhe si opsion i fundit.⁵⁰ Për shembull, vrasja e një personi në vetëmbrojtje justifikohet vetëm si opsion i fundit, kur në ato rrethana nuk ka asnjë alternativë të arsyeshme.⁵¹

24. Gjithashtu, vetëmbrojtja nuk mund të përdoret si argument mbrojtës për të përligjur shkeljen e një ndalimi ligjor që njihet si absolut nga e drejta ndërkombëtare. Kështu, për shembull, Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së në çështjen *Martić*, vuri në dukje se, duke pasur parasysh faktin që sipas të drejtës ndërkombëtare ndalimi i sulmit ndaj civilëve është absolut, veprimet e të akuzuarit nuk mund të përligjen nga asnjë argument se veprimi ushtarak u ndërmor për vetëmbrojtje.⁵² E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vepra penale të tjera për të cilat përcaktohen ndalime absolute në të drejtën ndërkombëtare, si për shembull, tortura.⁵³

⁴⁹ LRTWC, Vol. I, pp. 1-21, at pp. 11-12, 15-16.

⁵⁰ *Shih p.sh.* LRTWC, Vol. III, pp. 77-80, Vol. XIII, pp. 149-150.

⁵¹ LRWTC, Vol. 15, p. 177. *Shih gjithashtu* LRTWC, Vol. III, pp. 77-80; LRTWC, Vol. XIII, pp. 149-50.

⁵² [Martić Appeal Judgment](#), para. 268. Një parim dhe përjashtim i ngjashëm vlen edhe në kontekstin e së drejtës së një shteti për të përdorur forcën ndaj një shteti tjetër në vetëmbrojtje, për sa i përket normave absolute të së drejtës ndërkombëtare. *Shih* International Law Commission, Draft Articles on Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts (“DARSIWA”), November 2001, Supplement No. 10 (A/56/10), Article 26 (dhe shpjegimet përkatëse). Kjo nënkupton që një shtet nuk mund të justifikojë veprime të ndërmarra, të cilat janë në shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare, duke paraqitur si arsye pretendimin e vetëmbrojtjes. *Shih, p.sh.* ICJ, [Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons](#), para. 42; ICRC Commentary, para. 1927; DARSIWA, Article 21 (dhe shpjegimet përkatëse).

⁵³ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Furundžija*, IT-95-17/1-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), 10 December 1998, paras 144, 153, 156; [Čelebići Trial Judgment](#), paras 453–54; *Prosecutor v. Kunarac et al.*, IT-96-23-T & IT-96-23/1-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 22 February 2001, para. 466; *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber II, [Judgement \(Volume 1 of 3\)](#), 27 March 2013, para. 52; *Prosecutor v. Krnojelac*, IT-97-25-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), 15 March 2002, para. 182; *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 172, footnote 225; *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-T, Trial Chamber, [Judgement](#), 31 March 2003, para. 336; *Prosecutor v. Simić et al.*, IT-95-9-T, Trial Chamber II, [Judgement](#), 17 October 2003, para. 34; ECCC, *Prosecutor v. Duch*, 001/18-07-2007/ECCC/TC, [Judgement](#), 26 July 2010, para. 352; *Prosecutor v. Nuon Chea & Khieu Samphân*, 002/19-09-2007/ECCC/TC, [Case 002/01 Judgment](#), 7 August 2014, para. 702; ICC, *Situation in the Islamic Republic of Afghanistan*, [Public Redacted Version of “Request for Authorisation of an Investigation Pursuant to Article 15”](#), 20 November 2017, ICC-02/17-7-Conf-Exp,

25. Bazuar në sa më lart, për të qenë e pranueshme, prova që thuhet se ka lidhje me vetëmbrojtjen duhet të jetë provuese për një ose disa nga elementet e këtij argumenti mbrojtës të paraqitura më lart. E njëjta gjë vlen, *a priori*, për konstatimet gjyqësore të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera që thuhet se janë relevante për vërtetimin e argumentit të vetëmbrojtjes.

26. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Thaçit pretendon se argumenti i vetëmbrojtjes është relevant për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të cilat ZPS-ja ia atribuon z. Thaçi.⁵⁴ Edhe sipas vetë parashtrimeve të Mbrojtjes, faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera që përdorin vetëmbrojtjen si justifikim për vërtetimin e ligjshmërisë së sjelljes së z. Thaçi mund të përjashtohen në bazë të rregullës 157(2), e cila ndalon konstatimin gjyqësor të fakteve që lidhen me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarit për të cilat janë ngritur akuzat në Aktakuzë.⁵⁵ Megjithatë, Trupi Gjykses nuk ka nevojë të marrë vendim tani për këtë aspekt sepse Mbrojtja është duke propozuar fakte të shqyrtuara në procese të tjera edhe lidhur me pika dhe arsytetime të tjera.⁵⁶

27. Trupi Gjykses i ka vlerësuar faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera bazuar në analizën e mësipërme.

28. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se në fund të gjykimit (dhe/ose në fazën e rregullës 130) palëve do t'u jepet mundësi e plotë dhe e drejtë që të bëjnë parashtrime ligjore dhe faktike relevante lidhur me zbatueshmërinë e pretendimit të vetëmbrojtjes për faktet e kësaj çështjeje gjyqësore. Rrjedhimisht, konstatimet e tanishme janë paraprake dhe vetëm për të vendosur nëse është vërtetuar që ndonjë

ICC-02/17-7-Red, 20 November 2017, paras 347–349, 354; AEC, *Prosecutor v. Habré*, [Judgement](#), 30 May 2016, para. 1541. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Nada v. Switzerland*, 10593/08, [Judgment \[GC\]](#), 12 September 2012, para. 47; *Al-Adsani v. United Kingdom*, 35763/97, [Judgment](#), 21 November 2001, para. 61; ICJ, *Questions Relating to the Obligation to Prosecute or Extradite (Belgium v. Senegal)*, [Judgment](#), *I.C.J. Reports 2012*, p. 422, para. 99.

⁵⁴ *Shih* më sipër para. 17.

⁵⁵ *Shih* më sipër para. 13.

⁵⁶ Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, para. 9.

nga faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera të paraqitura nga Mbrojtja përfshihet në kuadrin material të pretendimit për vetëmbrojtje të paraqitur nga Mbrojtja e Thaçit.

C. FAKTET E PROPOZUARA TË SHQYRTUARA NË PROCESË TË TJERA LIDHUR ME EKZISTENCËN, LLOJIN DHE KUADRIN KOHOR TË KONFLIKTIT TË ARMATOSUR

29. Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykes që të bëjë konstatim gjyqësor të faktit në vijim, për të cilin është bërë konstatim nga dy gjykata në Kosovë:

Në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur i cili zgjati deri në marrëveshjen për planin ndërkombëtar të paqes midis NATO-s dhe RFJ-së më 9 qershor 1999.⁵⁷

30. Nga kjo rrjedhin dy pyetje: (i) nëse Trupi Gjykes është i autorizuar të bëjë konstatim gjyqësor për ekzistencën, llojin dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur të pretenduar; dhe (ii) nëse merret si e qenë se Trupi Gjykes mund ta bëjë këtë konstatim, si duhet ta ushtrojë Trupi Gjykes diskrecionin e tij për të bërë (ose për të mos bërë) konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera.⁵⁸

31. Trupi Gjykes vëren se përcaktimi i ekzistencës, llojit dhe kuadrit kohor të konfliktit të armatosur përfshin aspekte të ndërthurura faktike dhe ligjore.⁵⁹ Trupi

⁵⁷ Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, Shtojca A, fakti i propozuar 133 i shqyrtuar në procese të tjera.

⁵⁸ Në lidhje me diskrecionin e Trupit Gjykes për këtë pikë, shih rregullën 157(2) të Rregullores ("mund të, në interes të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë"). Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 12 November 2013, para. 24; *Nikolić v. Prosecutor*, IT-02-60/1-A, Appeals Chamber, [Decision on Appellant's Motion for Judicial Notice](#), 1 April 2005, para. 11; *Prosecutor v. Milosević*, IT-02-54-AR73.5, Appeals Chamber, [Decision on the Prosecution's Interlocutory Appeal Against the Trial Chamber's 10 April 2003 Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 October 2003, p. 4; *Prlić et al. Decision*, para. 9; *Hadžihasanović and Kubura Decision*, p. 4; *Karadžić 14 June 2010 Decision*, para. 15; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Third Motion for Reconsideration of Decision on Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 14 September 2010, para. 8; *Popović et al. Decision*, para. 15; *Stanišić and Župljanin Decision*, para. 45; *Hadžić Decision*, para. 13.

⁵⁹ *Shih F01337*, Trupi Gjykes II, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Zvogëlimin e Kuadrit të Akuzave në Aktakuzë* ("Vendimi mbi Mocionin për Zvogëlimin e Kuadrit të Akuzave"), 2 mars 2023,

Gjykues vëren gjithashtu se, sikurse u theksua më lart, duket se rregulla 157(2) kufizon mundësinë e Trupit Gjykues për të bërë konstatim gjyqësor lidhur me konstatimet *faktike*.⁶⁰

32. Ky interpretim i rregullës 157(2) mbështetet nga jurisprudenca dhe praktika që lidhen me bërjen e konstatimeve gjyqësore për ekzistencën, llojin dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur. Së pari, në çështjen *Mustafa*, Trupi Gjykues I bëri konstatim gjyqësor të fakteve relevante për përcaktimin ose deduktimin e ekzistencës, llojit dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur, por nuk bëri konstatim gjyqësor mbi konstatimet e tribunalëve të tjerë për ekzistencën, llojin dhe kuadrin kohor faktik të këtij konflikti.⁶¹ Një qasje e ngjashme shihet edhe në praktikën e TPNJ-së, ku u zbatua një rregull përgjithësisht e krahasueshme.⁶² TPNJ-ja e bëri të qartë se, ndonëse prania e terminologjisë ligjore në një konstatim që përndryshe është faktik nuk e bën të pamundshëm bërjen e konstatimit gjyqësor për të, për konstatimet që në thelb janë të llojit ligjor, ato që paraqesin kryesisht argumente juridike, ose që përmbajnë cilësime ligjore të fakteve, nuk do të bëhej konstatim gjyqësor.⁶³ Kjo vlen sidomos për konstatimet në lidhje me

para. 19; F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 89 (versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED; versioni i redaktuar publik u lëshua më 30 nëntor 2020, F00026/RED); ICTY, *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-PT, Trial Chamber II, [Decision on Johan Tarčulovski's Motion Challenging Jurisdiction](#), 1 June 2005, para. 11; *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-AR72.1, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutory Appeal on Jurisdiction](#), 22 July 2005, para. 13; *Prosecutor v. Bošković and Tarčulovski*, IT-04-82-T, Trial Chamber II, [Decision on Bošković Defence Motion for Admission of Exhibits from the Bar Table - "Armed Conflict" and Related Requirements under Article 3 of the Statute](#), 27 February 2008, para. 6; *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-PT, Trial Chamber I, [Decision on Several Motions Challenging Jurisdiction](#), 19 March 2007, para. 42.

⁶⁰ *Shih sipër* para. 13.

⁶¹ Vendimi në Çështjen *Mustafa*, para. 12-14. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00144, Mocion i Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera, 30 qershor 2021, me Shtojcën 1.

⁶² Rregulla 94(B) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së.

⁶³ *Shih p.sh.* *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-T, Trial Chamber III, *Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts ("Lukić and Lukić Decision")*, 22 August 2008, paras 24-25; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-T, Trial Chamber III, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts of 14 and 23 June 2006](#), 7 September 2006, para. 23; *Prosecutor v. Šešelj*, IT-03-67-T, Trial Chamber III, [Decision on the Prosecution Motion to Take Judicial Notice of Facts Under](#)

elementet e përgjithshme ose kontekstuale të neneve 3 dhe 5 të Statutit të TPNJ-së, ndër të cilat ato për ekzistencën, llojin dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur.⁶⁴ Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për jurisprudencën e TPNR-së dhe GJSSL-së, ku disa Dhoma kanë bërë konstatime gjyqësore për ekzistencën (dhe/ose llojin) e konfliktit të armatosur, dhe jo thjesht të fakteve relevante për nxjerrjen e përfundimeve për to.⁶⁵ Pa hyrë në trajtimin e meritave të kësaj qasjeje dhe përputhshmërinë e saj me prezumimin e pafajësisë dhe me përgjegjësitë e Trupit Gjykses (*iura novit curia*), Trupi Gjykses konstaton se precedentët nga TPNR-ja dhe GJSSL-ja dallojnë nga situata në rastin tonë. Të dyja ato gjykata kishin juridiksion vetëm mbi konflikte të armatosura jondërkombëtare.⁶⁶ Në dallim prej tyre, në juridiksionin aktual, përgjegjësia për të përcaktuar ekzistencën ose jo të

[Rule 94\(B\) of the Rules of Procedure and Evidence](#), 10 December 2007, para. 15. *Shih gjithashtu Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-03-69-T, Trial Chamber I, [Decision on Second Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 January 2010, paras 24, 39-43.

⁶⁴ Lidhur me elementet e përgjithshme/kontekstuale të nenit 3 të Statutit të TPNJ-së (krime lufte), *shih p.sh. Lukić and Lukić Decision*, para. 25; *Prosecutor v. Simić et al.*, IT-95-9-T, Trial Chamber, [Decision on the Pre-Trial Motion by the Prosecution Requesting the Trial Chamber to Take Judicial Notice of the International Character of the Conflict in Bosnia-Herzegovina](#), 25 March 1999, pp. 4-5; *Prosecutor v. Sikirica et al.*, IT-95-8-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 27 September 2000, pp. 5-6. Lidhur me elementët e përgjithshëm të nenit 5 të Statutit të TPNJ-së (krime kundër njerëzimit), *shih gjithashtu Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-PT, Trial Chamber I, [First Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts](#), 28 February 2012, para. 38.

⁶⁵ ICTR, *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-T, Trial Chamber III, [Judgement and Sentence](#), 15 May 2003, para. 281. *Shih gjithashtu Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-20-I, Trial Chamber III, [Decision on the Prosecutor's Motion for Judicial Notice and Presumption of Facts Pursuant to Rules 94 and 54](#), 3 November 2000, para. 48, Annex A, para. 3; ICTR, *Semanza v. Prosecutor*, ICTR-97-20-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 May 2005, paras 191-192; ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-AR73(C), Appeals Chamber, [Decision on Prosecutor's Interlocutory Appeal of Decision on Judicial Notice](#), 16 June 2006, para. 29; *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-AR73(C), Appeals Chamber, [Decision on Motions for Reconsideration](#), 1 December 2006, para. 11; SCSL, *Prosecutor v. Norman et al.*, SCSL-2004-14-AR73, Appeals Chamber, [Decision on Appeal Against "Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice and Admission of Evidence"](#), 16 May 2005, paras 34-40; *Prosecutor v. Brima et al.*, SCSL-04-16-PT, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecution Motion for Judicial Notice and Admission of Evidence](#), 25 October 2005, paras 29-31; *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 2 March 2009, para. 969.

⁶⁶ *Shih* ICTR Statute, Article 4; SCSL Statute, Articles 3-4. *Shih gjithashtu* United Nations Security Council, *Report of the Secretary-General Pursuant to Paragraph 5 of Security Council Resolution 955 (1994)*, UN Doc. S/1995/134, 13 February 1995, para. 11; United Nations Security Council, *Report of the Secretary-General on the Establishment of a Special Court for Sierra Leone*, UN Doc. S/2000/915, 4 October 2000, paras 14-16, 22.

konfliktit të armatosur, llojin dhe kuadrin kohor të atij konflikti, i është dhënë vetë Trupit Gjykses në kuadër të përgjegjësi të tij juridike dhe të konstatimit të fakteve.

33. Sa i përket pikës së dytë, Trupi Gjykses vë në dukje se aspekti i fillimit dhe përfundimit të konfliktit të armatosur jondërkombëtar që lidhet me këtë çështje gjyqësore është aktualisht objekt debati juridik mes palëve. Palët pajtohen se në Kosovë ekzistonte konflikt i armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së në njërin anë, dhe forcave serbe dhe jugosllave në anën tjetër, së paku midis 30 nëntorit 1998 dhe 9 qershorit 1999,⁶⁷ por nuk pajtohen lidhur me: (i) nëse ky konflikt ekzistonte në mars 1998 dhe (ii) nëse ai vazhdoi pas qershorit 1999 (deri në shtator 1999).⁶⁸

34. Trupi Gjykses do të bëjë konstatime lidhur me këto aspekte në aktgjykim, bazuar në të gjitha provat e pranuar gjatë gjykimit.⁶⁹ Sikurse kanë vënë në dukje palët, gjykata dhe dhoma gjyqësore të ndryshme kanë arritur përfundime të ndryshme lidhur me kuadrin e saktë kohor të konfliktit.⁷⁰ Kjo pasqyron faktin se gjykatat dhe dhomat e ndryshme u përqendruan në aspekte pjesërisht të ndryshme të të njëjtit konflikt dhe/ose kishin në dispozicion prova të ndryshme.

⁶⁷ CRSPD 213, 10 maj 2023. Në përgjigjen e datës 13 mars 2023, ZPS-ja saktësoi se fakti që ajo pajtohej se gjatë asaj periudhe ekzistonte konflikt i armatosur jondërkombëtar “nuk paragjykonte qëndrimin e ZPS-së se konflikti i armatosur jondërkombëtar në Kosovë ka ekzistuar gjatë gjithë periudhës së krimeve të paraqitura në Aktakuzë”.

⁶⁸ F00709, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Korrigjuar të Prokurorisë dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 24 shkurt 2022, me Shtojcat 1, 3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale, Shtojca 1 (“Dosja Paraprake e ZPS-së”), para. 697-701 (versioni me më pak redaktime i dosjes paraprake të ZPS-së u dorëzua më 15 shkurt 2023, F01296/A01); F01049, Mbrojtësi i Specializuar, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Selimit*, 21 tetor 2022, konfidenciale, para. 177-181); F01050, Mbrojtësi i Specializuar, *Dosja Paraprake e z. Hashim Thaçi*, 21 tetor 2022, konfidenciale, para. 75-78 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 nëntor 2022, F01050/RED); F01051, Mbrojtësi i Specializuar, *Dosja Paraprake e Jakup Krasniqit*, 21 tetor 2022, konfidenciale, para. 125-132; F01052/COR, Mbrojtësi i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Dosjes Paraprake në Emër të Kadri Veselit, me Shtojcat Konfidenciale 1-3 (të datës 21 tetor 2022, F01052)*, 25 tetor 2022, para. 138-139 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 mars 2023, F01052/COR/RED); Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1838-1855.

⁶⁹ *Shih* Vendimin për Zvogëlimin e Kuadrit të Akuzave, para. 19.

⁷⁰ Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1845-1846, 1851-1853.

35. Rrjedhimisht, edhe nëse Trupi Gjykses do të kishte kompetencë të bënte konstatim gjyqësor për ekzistencën, llojin dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur që lidhet me këtë çështje gjyqësore, ai do të kishte ushtruar diskrecionin e vet për të mos bërë konstatim gjyqësor për arsyet e shtjelluara më lart.

IV. DISKUTIM

A. PARASHTRIMET E PALËVE

36. Mbrojtja parashtron se faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera janë të përshtatshme për konstatim gjyqësor duke qenë se ato: (i) janë “të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme”; (ii) nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga formulimi i aktgjykimit original; (iii) nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin e paraqitur; (iv) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal; dhe (v) nuk janë në proces apeli apo rishikimi.⁷¹ Mbrojtja pretendon se: (i) faktet e propozuara 1-36 të shqyrtuara në procese të tjera kanë lidhje me rrethanat historike të konfliktit të armatosur; (ii) faktet e propozuara 37-105 të shqyrtuara në procese të tjera lidhen me disa sulme mbi popullatën shqiptare të Kosovës që ndodhën në afërsi gjeografike dhe kohore me ngjarjet dhe akuzat në këtë çështje gjyqësore; ato ofrojnë informacion historik dhe kontekstual të rëndësishëm për pretendimet në këtë çështje dhe janë relevante për nivelin e organizimit dhe strukturën e UÇK-së gjatë periudhës që mbulon Aktakuza, si edhe për Njoftimin e Thaçit për Argument Mbrojtës; (iii) faktet e propozuara 106-125 të shqyrtuara në procese të tjera janë veçanërisht relevante për nivelin e organizimit dhe strukturën e UÇK-së gjatë periudhës që mbulon Aktakuza dhe rrjedhimisht janë relevante për pretendimet në këtë çështje gjyqësore; dhe (iv) faktet e propozuara 126-134 të shqyrtuara në procese të tjera lidhen me ekzistencën dhe kuadrin kohor të konfliktit të armatosur midis

⁷¹ Mocioni i Përbashkët i Mbrojtjes, para. 7.

UÇK-së dhe forcave të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, që luftonin së bashku me forcat serbe, dhe rrjedhimisht lidhen me elementin kontekstual të krimeve të luftës.⁷²

37. ZPS-ja përgjigjet se: (i) gjashtëdhjetë e dy fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera që lidhen me krimet e forcave serbe nuk janë relevante për argumentin e vetëmbrojtjes apo për organizimin e UÇK-së dhe nuk mjafton të argumentohet se ato ofrojnë informacion për kontekstin ose rrethanat historike;⁷³ (ii) dhjetë fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera janë përsëritje ose përmbledhje të pjesshme ose të plota të dëshmive dhe, për rrjedhojë, nuk përmbushin kriterin për të qenë konstatime faktike;⁷⁴ (iii) tetë fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera janë në thelb të llojit ligjor;⁷⁵ (iv) trembëdhjetë fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera janë riformuluar në mënyrë të pasaktë dhe dhjetë fakte të propozuara janë çorientuese, përfshirë për arsye se janë nxjerrë jashtë kontekstit, dhe rrjedhimisht ndryshojnë konsiderueshëm nga formulimi në aktgjykimin origjinal;⁷⁶ (v) nëntë fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera janë të mjegullta dhe/ose të pasakta dhe nuk plotësojnë kriterin se duhet t'u referohen konkretisht konstatimeve faktike të dallueshme dhe të identifikueshme dhe/ose të citojnë pjesët dhe paragrafët nga aktgjykimi për të cilat propozohet të bëhet konstatim gjyqësor;⁷⁷ dhe (vi) katër fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera përdorin formulim të cilësuar ose bazohen në "konstatime negative" të arritura plotësisht ose pjesërisht si rezultat i mungesës ose i pamjaftueshmërisë së provave në një çështje gjyqësore të caktuar.⁷⁸

38. Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja kërkon përjashtimin e provave për krimet

⁷² Kërkesa e Përbashkët e Mbrojtjes, paras 8-11. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2-13. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 14. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 15. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 16. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 17. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

⁷⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 18. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së ZPS-së.

e kryera nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës mbi bazën se ato nuk janë relevante, ndërsa sipas Mbrojtjes, këto fakte janë qartësisht relevante për kontekstin, ndër të tjera për sa u përket deklaratave publike relevante, motivit të luftëtarëve të UÇK-së dhe të të akuzuarve, dhe motivit të hakmarrjes së individëve që kryen krimet e pretenduara.⁷⁹ Mbrojtja argumenton se faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera nuk dallojnë konsiderueshëm në formulim nga aktgjykimet origjinale dhe se formulimi i fakteve nuk ka nevojë të jetë identik si në aktgjykimin origjinal, por duhet të jetë i ngjashëm në masë të konsiderueshme.⁸⁰ Mbrojtja pretendon se: (i) faktet janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme; dhe se (ii) është i gabuar pretendimi i ZPS-së se një numër faktesh përdorin formulime cilësuese ose bazohen në “konstatime negative” të arritura plotësisht ose pjesërisht si rezultat i mungesës ose pamjaftueshmërisë së provave në çështjen gjyqësore përkatëse.⁸¹

B. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

39. Trupi Gjykses ka përcaktuar më lart dispozitat ligjore përkatëse dhe do të përvijojë shkurtimisht se si e ka zbatuar ligjin gjatë marrjes së vendimit mbi këtë kërkesë. Së pari, Trupi Gjykses kreu një analizë më vete të secilit fakt. Në rastet kur fakti i propozuar përmbante disa fjali dhe/ose propozime faktike, Trupi Gjykses shqyrtoi secilën prej tyre. Trupi Gjykses verifikoi nëse secili prej fakteve të propozuara të shqyrtuara në çështje të tjera i përmbushte kriteret e Rregullores dhe, në qoftë se po, nëse fakti në fjalë sidoqoftë duhej rrëzuar në bazë të diskrecionit të Trupit Gjykses. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka marrë parasysh faktin se përgjegjësinë e vërtetimit për përmbushjen e kriterëve të Rregullores e ka

⁷⁹ Kundërpërgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 3. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen e Përbashkët të Mbrojtjes, para. 4-12.

⁸⁰ Kundërpërgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 13-14.

⁸¹ Kundërpërgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 15-16.

pala që parashtron kërkesën.⁸² Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja nuk paraqiti parashtrime më vete për secilin prej fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, por i organizoi parashtrimet në kategori të përgjithshme.⁸³

40. Gjatë ushtrimit të diskrecionit, Trupi Gjykses ka marrë parasysh një numër faktorësh. Së pari, Trupi Gjykses hodhi poshtë faktet që nuk kishin lidhje të qartë dhe të vërtetueshme me pikat që kontestohen në procesin aktual. Megjithatë, në raste kur faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera përmbanin material jorelevant (për shembull, prova të krimeve serbe), por përmbanin edhe tregues të faktorëve potencialisht relevantë (për shembull, për aftësitë operationale të forcave serbe që mund të jenë relevante për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur jondërkombëtar), Trupi Gjykses mori vendim në favor të palës që parashtrori kërkesën dhe pranoi ato pjesë të fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera të cilat mund t'i lidhte me një aspekt relevant për procesin aktual. Në rastet kur pala që parashtrori kërkesën nuk arriti të demonstronte ekzistencën e kësaj lidhjeje, Trupi Gjykses refuzoi të bënte konstatim gjyqësor të faktit të propozuar (fakteve të propozuara) të shqyrtuar (shqyrtuara) në procese të tjera.

41. Gjithashtu, Trupi Gjykses ushtroi diskrecionin e vet për të mos bërë konstatim gjyqësor në rastet kur faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera ishin të lidhura tejet ngushtë me një pikë të rëndësishme që është objekt kontestimi në procesin aktual. Trupi Gjykses është i mendimit se konstatimi gjyqësor i atyre fakteve do të kursente shumë pak kohë dhe se për ato fakte duhet të vendoset në bazë të provave të parashtruara para këtij Trupi Gjykses, e jo në

⁸² *Shih* ICTY, [Popović et al. Decision](#), para. 21; *Prosecutor v. Milosević*, IT-98-29/1-T, Trial Chamber III, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Prosecution's Catalogue of Agreed Facts with Dissenting Opinion of Judge Harhoff](#), 10 April 2007, para. 29; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber, Judgement and Sentence, 10 June 2010, para. 1611; [Tolimir Appeal Judgment](#), para. 24.

⁸³ *Shih* Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes, para. 8-11. *Shih gjithashtu* më sipër para. 36.

bazë të konstatimeve që kanë bërë të tjerët.

42. Trupi Gjykses refuzoi gjithashtu të bëjë konstatim gjyqësor për një numër faktesh të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera kur ato ishin të mjegullta, të paqarta, tejet të përgjithshme dhe u mungonte konteksti ose nuk kishin konkretësi faktike të mjaftueshme për të ndihmuar Trupin Gjykses në përmbushjen e përgjegjësisë së tij për gjykimin e fakteve.

43. Në disa raste, Trupi Gjykses i riformuloi *proprio motu* faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, për t'i bërë ato më përputhëse me formulimin origjinal të konstatimeve të tribunalit përkatës, ose për të pasqyruar informacionin shtesë që përmbanin ato konstatime. Trupi Gjykses bëri gjithashtu konstatim gjyqësor të një pjese të një fakti të propozuar të shqyrtuar në procese të tjera në rastet kur vetëm ajo pjesë përmbushte kriterin e rregullës 157(2), ose kur Trupi Gjykses ushtroi diskrecionin e vet për të mos bërë konstatim gjyqësor të pjesëve të caktuara të faktit të propozuar. Trupi Gjykses ka pranuar gjithashtu riformulime të vogla të konstatimeve të sugjeruara nga Mbrojtja, në rastet kur ato i bënin faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera më të kuptueshme dhe nuk shtrembëronin thelbin e konstatimeve origjinale.⁸⁴

C. VLERËSIM I FAKTEVE TË PROPOZUARA TË SHQYRTUARA NË PROCESË TË TJERA

44. Trupi Gjykses është bindur se të gjitha faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera burojnë nga procese të tjera të Dhomave të Specializuara ose nga proceset e përfunduara në gjykata të tjera të Kosovës ose në juridiksione të tjera.

45. Pasi shqyrtoi secilin prej fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera më vete, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se disa prej tyre kanë të bëjnë me aspektet që po gjykohen në procesin aktual. Në

⁸⁴ *Shih p.sh.* Shtojcën 1 të këtij vendimi, fakti 770 i shqyrtuar në procese të tjera (fakti 113 i propozuar nga Mbrojtja i shqyrtuar në procese të tjera) ku formulimi “periudha e Aktakuzës” në konstatimin origjinal zëvendësohet me “nga marsi deri në shtator 1998”.

lidhje me këtë, Trupi Gjykses përsërit se kryerja e krimeve nga pala kundërshtare nuk është relevante për këtë çështje gjyqësore, përveç nëse lidhet drejtpërdrejt me një fakt që po gjykohet në këtë çështje gjyqësore.⁸⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton kriteret që rregullojnë pranimin e provave për vetëmbrojtje.⁸⁶ Në rastet kur nga parashtrimet e Mbrojtjes dhe nga fakti në fjalë, nuk ishte e qartë relevanca e pretenduar e tyre për procesin aktual, Trupi Gjykses ka refuzuar të bëjë konstatim gjyqësor lidhur me të. Në veçanti, Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera (ose pjesë të tyre): 10, 15-18, 20-21, 27, 37, 38, 43, 46-48, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 59-61, 63-73, 74, 76-77, 78, 79-80, 81, 82-85, 87-105, 109, dhe 110, kanë lidhje me aspektet që po gjykohen në procesin aktual.

46. Sikurse u tha më lart, faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera që mbështesin pretendimin e vetëmbrojtjes duhet të përmbushin kriteret e rregullës 157(2) se ato nuk lidhen me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzë.⁸⁷ Trupi Gjykses vë në dukje se faktet e propozuara 121-122 të shqyrtuara në procese të tjera i afrohen lidhjes me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve. Përderisa ato nuk përbëjnë veprime dhe sjellje të të akuzuarve sikurse janë paraqitur në Aktakuzë, Trupi Gjykses ka ushtruar diskrecionin e vet që të mos bëjë konstatim gjyqësor të tyre, në mënyrë që këto aspekte të mund të debatohen plotësisht gjatë gjykimit. Përndryshe, Trupi Gjykses është bindur se asnjë prej fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera nuk ka të bëjë me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se disa prej fakteve të propozuara kanë të bëjnë me përgjegjësinë, autoritetin dhe/ose kompetencat e individëve që ZPS-ja pretendon se ishin vartës të të akuzuarve ose anëtarë ose instrumente të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Ndonëse rregulla 157(2) nuk i përjashton këto aspekte në

⁸⁵ Transkripti i seancës, 16 dhjetor 2022, f. 1725-1726.

⁸⁶ *Shih* më sipër para. 21-25.

⁸⁷ *Shih* më sipër para. 13, 26.

vetvete, Trupi Gjykses ka ushtruar diskrecionin e vet që të mos bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara 114, 117-118 të shqyrtuara në procese të tjera, në mënyrë që këto aspekte të mund të trajtohen dhe për to të merret vendim mbi bazën e provave që do të paraqiten gjatë gjykimit.

47. Sikurse u tha më lart, Trupi Gjykses nuk është i autorizuar të bëjë konstatime gjyqësore për konstatime që janë në thelb të llojit ligjor, që paraqesin kryesisht argumente juridike ose që përmbajnë cilësime ligjore të fakteve.⁸⁸ Trupi Gjykses evidentoi një numër faktesh të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera (ose pjesë të tyre) që ishin të llojit ligjor dhe/ose përmbanin konstatime ligjore që nuk përfshihen në kuadër të rregullës 157(2), ose për të cilat Trupi Gjykses ushtron diskrecionin e tij për të mos bërë konstatim gjyqësor. Kjo ka të bëjë me faktet e propozuara 14, 15-17, 21, 120, dhe 133 të shqyrtuara në procese të tjera.

48. Gjithashtu, Trupi Gjykses vlerëson se një numër faktesh të shqyrtuara në procese të tjera nuk kanë qartësi, kontekst, ose konkretësi të mjaftueshme për ta ndihmuar Trupi Gjykses në kryerjen e funksioneve të tij për gjykimin e fakteve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka refuzuar të bëjë konstatim gjyqësor të faktit të propozuar 58 të shqyrtuar në procese të tjera, si edhe të pjesëve të fakteve të propozuara 8 dhe 26 të shqyrtuara në procese të tjera.

49. Trupi Gjykses gjithashtu ushtroi diskrecionin e vet dhe refuzoi të bënte konstatim gjyqësor të disa fakteve në rastin kur fakti në fjalë është aktualisht objekt kontestimi në këtë çështje gjyqësore dhe përbën një aspekt kyç të çështjes, në veçanti sa i përket funksionimit dhe organizimit të strukturës së UÇK-së. Kjo vlen për faktet e propozuara 114, 116-125, 127, 130 dhe 131 të shqyrtuara në procese të tjera.

50. Trupi Gjykses ka ushtruar gjithashtu diskrecionin e tij në lidhje me refuzimin e fakteve të propozuara 22 dhe 134 të shqyrtuara në procese të tjera, sepse ato

⁸⁸ *Shih* më sipër para. 14, 32.

pasqyrojnë përmbajtjen e dokumentit/provës materiale, e jo konstatimin faktik të një tribunali. Në rast se Mbrojtja dëshiron të mbështetet në përmbajtjen e këtyre dokumenteve, ajo mund t'i paraqesë ato në bazë të rregullës 138. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se fakti 132 thjesht përsërit faktin 126 të shqyrtuar në procese të tjera. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do të bëjë konstatim gjyqësor vetëm të faktit 126 të shqyrtuar në procese të tjera. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se faktet e propozuara 6, 7, 26-36, 41, 44, 49, 53, 115, 129-131, dhe 134 të shqyrtuara në procese të tjera përkojnë me disa fakte ose pjesë faktesh të shqyrtuara në procese të tjera që janë propozuar nga ZPS-ja, për të cilat Trupi Gjykses tanimë ka bërë konstatim gjyqësor.⁸⁹ Për të shmangur përsëritjen e konstatimeve të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera dhe pasi ka shqyrtuar me kujdes dallimet në formulimet të këtyre fakteve të propozuara nga Mbrojtja, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara 6, 7, 26-36, 41, 44, 49, 53, 115, 129-131, dhe 134 të shqyrtuara në procese të tjera.

51. Së fundi, sikurse është vënë në dukje më lart, Trupi Gjykses ka riformuluar *proprio motu* disa nga faktet e propozuara të shqyrtuara në procese të tjera në mënyrë që ato të përputhen më shumë me konstatimet origjinale. Kjo ka të bëjë me faktet e propozuara 1, 9, 11-12, 19, 39-40, 51, dhe 108 të shqyrtuara në procese të tjera. Gjithashtu, Trupi Gjykses riformuloi disa fakte të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, ose refuzoi të bëjë konstatim gjyqësor të pjesëve të tyre, kur gjykoi se faktet relevante të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera (ose pjesë të tyre) nuk përmbushnin kriterin e rregullës 157(2). Kjo ka të bëjë në veçanti me faktet e propozuara 8, 13-14, 26, 38,-53, 55, 74, 78, 81, dhe 110 të shqyrtuara në procese të tjera.

52. Pasi ka kryer vlerësimin veç e veç dhe të hollësishëm të çdo fakti të propozuar

⁸⁹ F01534, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera me Shtojcën 1 (Konfidenciale) dhe Shtojcën 2 (Publike)*, 17 maj 2023. *Shih* Shtojcat 1-2, faktet 59, 76, 87, 139, 141-143, 145, 148, 154-156, 160, 162, 167, 169, 171, 186-188, 250, 277-278, 280-281, 305 të shqyrtuara në procese të tjera.

të shqyrtuar në procese të tjera, dhe në zbatim të rregullës 157(2), Trupi Gjykses vjen në përfundimin se mund të bëhet konstatim gjyqsor i plotë ose i pjesshëm, dhe ndonjëherë sipas riformulimit të bërë prej Trupit Gjykses, i fakteve në vijim: 1-5, 8-9, 11-14, 19, 23-25, 38-40, 42, 45, 50-52, 55, 62, 74-75, 78, 81, 86, 106-108, 110-113, 126, dhe 128. Për shkallën në të cilën Trupi Gjykses ishte i gatshëm të bënte konstatim gjyqsor të fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, ose të pjesëve të tyre, jepen hollësi në Shtojcën 1 të këtij vendimi.

V. VENDIM

53. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON**, pjesërisht, Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes;
- b) **BËN KONSTATIM GJYQSOR**, të plotë ose të pjesshëm, të fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, sikurse janë ndryshuar nga Trupi Gjykses dhe sikurse paraqiten në Shtojcën 1 të këtij vendimi: 1-5, 8-9, 11-14, 19, 23-25, 38-40, 42, 45, 50-52, 55, 62, 74-75, 78, 81, 86, 106-108, 110-113, 126, dhe 128; dhe
- c) **REFUZON** të bëjë konstatim gjyqsor për të gjitha faktet e tjera të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, ose të pjesëve të tyre, që nuk janë përfshirë në Shtojcën 1 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte 18 maj 2023

Në Hagë, Holandë.